



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

## PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2016/2017

# TESTI GJUHË SHQIPE

### UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

**Të dëshirojmë sukses në punë!**

## 1. Flamujt e 28 Nëntorit

U gdhi një mëngjes i ftohtë e me shi. Një mëngjes me shi e me borë. Menjëherë të ngrinte lagështia. Nuk dihej kah po frynte. Rrëketë ecshin me ujë të turbull skaj gurëve anësor të udhës. Mbusheshin pusët e kalldrëmit me ujë të turbull baltë. Njerëzit ecshin pllaq e plluq. Nguteshin me ia lëshua rrugën ndonjë qerreje, ndonjë veture, ndonjë autoblinde. Zinxhirët gërryes lënin gjurmë të bardha mbi gurët e urës...

-Teksti i lartshënuar është i stilit:

- a) gazetaresk;
- b) poetik;
- c) letrar.

## 2. Nxënësit e shkollës fillore “Muharrem Kadriu” në Tërnovc së bashku me arsimtarët e tyre e vizituan shkollën e mesme “Memet Akif” në Prishtinë.

Nga vizita që i bënë kësaj shkolle ata u njoftuan mbi punën dhe ecurinë e procesit edukativo-arsimor.

Vizita ishte e frytshme dhe nxënësit u ndanë shumë të kënaqur me mbresa të veçanta.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

Teksti është:

- a) Reklamë;
- b) Lajm;
- c) Përshkrim.

## 3. Elefantët

- Elefantët janë kafshë më të mëdha në tokë. Pesha e tyre arrin disa qindra kilogramë.

- Me feçkën e tyre, elefantët mund të bartin pesha të mëdha dhe ata janë përdorur me të madhe në industrinë e pyjeve në Azi për shumë vjet. Ata përdorin feçkën e tyre për të pirë ujë, për të ngrënë, për t'u larë dhe për të komunikuar. Mendohet se, në këtë kohë, në Afrikë kanë jetuar dikur rreth 600,000 elefantë.

- Lexo me kujdes tekstin e lartshënuar dhe trego: Përse e përdorin feçkën elefantët?

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- ç) \_\_\_\_\_

4. Lexo fjalinë e dhënë dhe shkruaje drejtë ashtu si e kërkojnë rregullat drejtshkrimore dhe sintaksore.

Në këtë tryezë, të drejtë kan vetëm kalorësit të ungjen ma të mir të mbretnisë.

---

---

5. Lexo fjalinë e poshtëshënuar, shndërroje nga njëjësi në shumës:

*Ti je nxënës i mirë.*

---

6. Me shkronja dore, shkruaje në gjuhën standarde fjalinë e poshtëshënuar.

NANA E PIKLLUEME FSHINI NJERSËN NGA BALLI DHE DUL NGA DERA E SHPISË.

---

---

7. Nga fjalët e poshtëshënuara dallo rrënjën e fjalët.

a) fillestar \_\_\_\_\_

b) përfillje \_\_\_\_\_

c) fillorist \_\_\_\_\_

ç) oborrtar \_\_\_\_\_

d) pylltar \_\_\_\_\_

8. Në fjalinë e poshtëshënuar gjeje kallëzuesorin e kryefjalës.

*Nënvizoje atë:*

*Të bukura janë këngët e vendit tim.*

9. Lexo me kujdes fjalitë e mëposhtme dhe dallo cila prej tyre është fjali dëftore.

Qarko përgjigjen e saktë.

a) Ç'farë po gatuan Blina?

b) Rinesa këndon me pasion.

c) Rigon më jep topin.

**10.** Dallo bashkëtingëlloret e mbyllura nga ato fërkimore.

P, SH, B, ZH, T, S, D, Z, K, F, G, V, Q, TH, GJ, DH.

**11.** - Fjalët e mëposhtme shpjegoni si janë formuar:

mbivlerë  
zhvendos  
shpagim  
çrrënjës  
nënkalim

Qarko përgjigjen e saktë.

- a) fjalë të përbëra;
- b) me parashtesa;
- c) me prapashtesa.

**12.** Lexo fjalinë e dhënë. Pjesa e nënvizuar cilit lloj të fjalive të varura (nënrenditura) i takon? Rretho përgjigjen e saktë.

Blina po punon tani më mirë nga ç'punonte më parë:

Fjalja e varur e nënvizuar është:

- a) qëllimore;
- b) mënyrore;
- c) krahasore;
- d) lejore.

**13.** Trego në ç`rasën janë fjalët e nënvizuara?

- a) Blinën e vëreja para derës së shtëpisë.
- b) Loja e Rigonit është ndryshe.
- c) Gjyshi im është i mençur.
- ç) Prej Rinesës presim rezultate të mira.
- d) Gjyshit ia dhanë shpërblim.

**14.** Nënvido dhe shkruaj më poshtë bashkëtingëlloret grykore dhe ato dybuzore:

D, P, L, T, K, S, R, Y, M, Z, H, O, Q, G, V, F, B, I, A,

- a) \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

**15.** Poema e mjerimit

Kafshatë që s'kapërdihet asht or vlla mjerimi  
 kafshatë që të mbetet në fyt edhe të zë trishtimi  
 kur shef fytyra të zbeta edhe sy t'jeshilta  
 që t'shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita  
 edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin  
 të tan jetën e vet deri sa të vdesin

Migjeni

Poema e lartshënuar është

a) poezi me rimë

b) poezi pa rimë

**16.** Lexo vjershën me kujdes dhe shkruaj cilën figurë stilistike e ka përdor poeti.

Gjuhës shqipe

Të falem ty, o gjuhë – shkëmb  
 me rrënjët thellë në shkëmbënj  
 që cave qiellin kur t'u vrënj  
 dhe shembe bisha e shtërpënj  
 Pa mbete prapë;  
 shkrep e shtëng

Të falem, gjuhë shkrepëtim,  
 që shkrep në qiej e vrungullon  
 me bujë pyjesh bubullon  
 me gjemë detesh uturon  
 dhe je, sic ishe;  
 vetëtim.

a) krahasimin;

b) epitetin;

c) onomatopeja.

**17.** a) Mbolla li te plepi gjatë  
 Furkën, hallë madhe, furkën!  
 Si e mbolla donte thurur,  
 si e thura, donte ruajtur,  
 si e ruajta dhe u rrit ...

b) Mori e mira po ban vek,  
 ban qylyma e ban dyshek,  
 t'lumshin duert, sa rrept po qet!

Lexo vargjet dhe trego si quhen këto këngë:

Këngët e \_\_\_\_\_

Këto këngë i përkasin letërsisë \_\_\_\_\_

## 18. Lexo tekstet dhe trego çfarë lloji të teksteve janë

a) Esat Mekuli lindi në Plavë më 1916. Gjimnazi e kreu në Pejë më 1936. Qysh si i ri, filloi të merret me letërsi dhe me përkthime.

Studioi veterinarinë në Beograd ku diplomoi në vitin 1947. Ka botuar përmbledhjet: "Për ty", "Brigjet", "Dita e re" etj.

b) Im atë rrjedhte nga një familje italianësh mali të regjur me vështirësi e jetës, kurse nëna ime i përkiste një familjeje të moçme shqiptare.

U vendosën në Rohas, ashtu si pjesa më e madhe e fshatrave të Pampës....

Ernesto Sabato

a) Ky tekst quhet: Tekst \_\_\_\_\_

b) Ky tekst quhet: Tekst \_\_\_\_\_

## 19. Teksti i dhënë është nga tregimi "Gjahu i malësorëve" i Konstandin Kristoforidhit.

Ty-ty-ty, ty-ty-ty, ty-ty-yt! – bie brini i gjahut.

Kam-kum, kam-kum, kam-kum! – lehin qentë.

Taf-tuf, taf-tuf, taf-tuf!—kërcet pushka.

--Prite, o Kolë, se po të vjenë një thi i madh ...

Shkrimtari me mjeshtëri i imiton tingujt: të lehurit e qenit, krismën e pushkës dhe zërin e trumbetës.

Si quhet figura stilistike me të cilën imitohen tingujt e natyrës ose të shtazëve?

Figura e \_\_\_\_\_

## 20.

Çdo gjë në botë ka një fillim e një mbarim, edhe ylli që këputet në qiell. Koha e Aliut Kishte mbaruar dhe duhej të vdiste. Ama me armë në dorë, siç kishte jetuar.

Kurse të tjerët, gjithë sa e tradhtuan, duke ditur ç'bënin, ose nga budallallëku e makutëria (pangopësia), do të vdisnin qenësisht e do të mbaheshin mend vetëm për atë,që...

S'kishte kohë të hynte tek armët. Nxori jataganin me vështirësi dhe deshi të zbriste shkallëve, të përleshej në fushë të hapur. Plumbi i tretë i erdhi nga poshtë podrumit, i hyri në kofshë e deri në boshtin e kurrizit. Ra në gjuhë dhe u kap pas parmakut, deshi t'i buzëqeshte vdekjes, po s'pati kohë, u kthye dhe ra në shpinë.

- Lexo me kujdes fragmentin e shkëputur dhe trego (shkruaj) titullin e veprës letrare.